“Allahu i Lartmadhëruar u thotë banorëve të Xhenetit: "O banorët e Xhenetit!" - Të përgjigjemi me kënaqësi, o Zoti ynë! - i thonë ata. - A jeni të kënaqur? - i pyet Allahu. - E si të mos jemi të kënaqur kur na ke dhënë atë që s'i ke dhënë askujt tjetër prej krijesave të Tua?

Ebu Seid Hudriu (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: “Allahu i Lartmadhëruar u thotë banorëve të Xhenetit: "O banorët e Xhenetit!" - Të përgjigjemi me kënaqësi, o Zoti ynë! - i thonë ata. - A jeni të kënaqur? - i pyet Allahu. - E si të mos jemi të kënaqur kur na ke dhënë atë që s'i ke dhënë askujt tjetër prej krijesave të Tua? - thonë ata. - Unë do t'ju shpërblej edhe më mirë se kaq. - O Zot, çfarë paska më mirë se kaq? - Do ta lëshoj mbi ju kënaqësinë Time dhe kurrë s'do të hidhërohem me ju, - u thotë Allahu.”

[Sahih] [Muttefek alejhi]

Profeti ﷺ në këtë hadith tregon se Allahu i Lartësuar u thotë banorëve të Xhenetit teksa janë aty: "O banorë të Xhenetit!", sakaq ata i përgjigjen Atij duke i thënë: "Të përgjigjemi me kënaqësi, o Zoti ynë!" Allahu u thotë: "A jeni të kënaqur?" - Po, jemi të kënaqur. E si të mos jemi të kënaqur kur na ke dhënë atë që s'i ke dhënë askujt tjetër prej krijesave të Tua? - thonë ata. Allahu u thotë: "A t'ju shpërblejmë me diçka më të mirë sesa kjo?" - E cila gjë është më e mirë sesa kjo, o Zot? - thonë ata. Kështu, Allahu u thotë: "Do ta lëshoj mbi ju përherë kënaqësinë Time dhe kurrë s'do të hidhërohem me ju."

http://sunnah.global/hadeeth/sq/show/8343